



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 793 / Prot  
4

Tiranë, më 10/6/2019

VENDIM

Nr. 16, datë 10.6.2019

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Birn Albania”, përfaqësuar nga z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 793 Prot., datë 20.05.2019, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, me shkresat e datës 08.05.2019, ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion dokumentacioni i disponueshëm në lidhje me:

- 1- Kopje të dosjes me titull “Drejtimi për Internim Dëbimet nr. 254”
- 2- Kopje të dosjes me titull Historiku i S.Sh të D.P.B.T vol. 1
- 3- Kopje të dosjes me titull Historiku i S.Sh të D.P.B.T vol. 2

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me Urdhrin nr.167, datë 27.05.2019, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit u kontaktua me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit i cili sqaroi se: "Kërkesat e "Birn Albania", si bazë ligjore i referohen ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", por pjesë e kësaj praktike është edhe një kërkesë e plotësuar sipas formularit tip me bazë ligjore ligjin nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", ku kërkuesi kërkon vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar " ... me CD me postë ose në variant të printuar ose me transferim elektronik (e-mail) sipas dëshirës...".

Me Vendimin nr.317, datë 21.05.2019 të sektorit të kërkesave studimore/mediatike, një pjesë të dokumentacionit të kërkuar i është vënë në dispozicion për njohje kërkuarit. Duke qenë se pjesa tjetër e dokumentacionit është në proces përpunimi (dosja 254 mbi internimet), kërkuesi është sqaruar nëpërmjet e-mailit të datës 20.05.2019, se do t'i vendoset në dispozicion në një moment të dytë. Të gjitha sa më sipër tregojnë qartë se jo vetëm nuk kemi të bëjmë me refuzim për dhënie informacioni, por trajtim me përparësi për rastin dhe subjektin në fjalë.

Në përmbushje të detyrës dhe në zbatim të ligjit nr.45/2015, Autoriteti ka përpiluar formular standard aplikimi për individë dhe studiues/media me rregulla rigorozë, në mënyrë që objekti, qëllimi dhe përdorimi i informacionit, të jetë i përcaktuar saktë, po kështu dhe kriteret e përdorimit të këtij dokumentacioni. Dokumentacioni që administrojmë ka të bëjë jo vetëm me sigurinë kombëtare por dhe informacione të klasifikuara (në një nga katër nivelet e klasifikimit) dhe të dhëna personale, dhe për këtë arsye ligji nr. 45/2015, duke qenë ligj i posaçëm, prevalon mbi ligjin nr. 119/2014.

Në këtë kontest ligji nr. 119/2014, në çdo rast do të gjejë zbatim dhe mbetet i aplikueshëm ku është e mundur dhe nuk bie ndesh me ligjin organik, sidomos për informacionet mbi përbërjen, veprimtarinë, aktivitetin dhe dokumentacionin e prodhuar nga autoriteti, aktet me të cilat rregullohet dhe funksionon veprimtaria e kësaj strukture, të tilla si platformat, rregulloret, urdhrat dhe udhëzimet, indeksat, inventarët dhe mjetet e kërkimit në arkiv, siç dhe operohet nëpër të gjitha arkivat e sistemit, pasi nëse do të përdorej dhe të kërkohet mbi bazën e prerogativave të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" në Arkivin Qendror të Shtetit në Arkivin e Ministrisë së Mbrojtjes etj, nuk do të duhej as do të nevojiteshin rregullat, rregulloret dhe as ligjet e posaçme për aksesin në arkiva".

Pas parashtrimit të fakteve u hartua procesverbali i cili u nënshkrua pa vërejtje nga ana e përfaqësuesit të Autoritetit Publik.

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se "Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", me shkresën nr. 793/3 Prot., datë 28.05.2019, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me praninë e përfaqësuesit të Qendrës "Birn Albania" nga njëra anë dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik nga ana tjetër.

Gjatë seancës, palët rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të cituara më sipër. Gjithashtu Ankuesi nga ana e tij shtroi pretendimin se: "...duke qenë se informacioni i kërkuar është deklasifikuar, nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të parashikuara në ligjin nr. 45/2015 "Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", pasi në këtë mënyrë



*humbet qëllimi i deklasifikimit. Gjithashtu në ndjekje të procedurave të parashikuara në ligjin specifik, kërkesit i ndalohet përhapja e informacionit tek të tretët, ç'ka bie ndesh me interesin publik, qëllim për të cilin ai e kërkon dokumentacionin.*

Nga ana e tij, Autoriteti Publik argumentoi se: *"Informacioni mund të vendoset në dispozicion kërkesit për njohje, në përputhje me procedurën e parashikuar në ligjin specifik."*

Nga shqyrtimi i çështjes konstatohet se, objekti i kërkesave ka të bëjë me informacion i cili i nënshtrohet dhe rregullohet me dispozitat e ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë". Pra në parim nuk kemi të bëjmë me informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Autoriteti Publik ushtron veprimtarinë e tij mbi bazën e dokumentacionit të deklasifikuar, por ky fakt, nuk e ndryshon mënyrën e rregullimit të informacionit të kërkuar dhe as procedurën sipas së cilës informacioni mund të aksesohet. Në nenet 15 pika 5 dhe 17 pika 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" parashikohet e drejta e njohjes me informacionin arkivor të çdo lloji, por informacioni me të cilin operon Autoriteti Publik konsiderohet informacion arkivor, të cilin për nga natyra e veçantë që paraqet, legjislatori e ka gjykuar të arsyeshme ta rregullojë me ligj të posaçëm (pra ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë") sa i takon të gjitha aspekteve, përfshirë rrethin e personave që mund të kenë qasje në dokumentacion, afatet e vënies në dispozicion të tij, kritereve dhe cilësive që duhen përmbushur për të pasur qasje në dokumentacion apo që dokumentacioni të vihet në dispozicion të kërkuësve, të drejtat e kërkuësit dhe niveli i aksesit në këtë dokumentacion etj.

Për këtë arsye, vlerësohet se nuk ndodhemi në kushtet e informacionit të kërkuar sipas Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".

Në bazë të nenit 36 të ligjit nr. 45/2015 "*Informimi për qëllime kërkimore dhe historike*", në funksion të veprimtarisë hulumtuese dhe kërkimit shkencor, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit apo të edukimit qytetar, Autoriteti vë në dispozicion, mbi bazë kërkesë, dokumente që nuk përmbajnë të dhëna personale apo publikata të anonimizuara.

Në këtë këndvështrim, Komisioneri vlerëson se, argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik për publikimin e informacionit në përputhje me procedurën e parashikuar në ligjin nr. 45/2015 "Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" pas përfundimit të procesit të anonimizimit rezulton i bazuar në ligj.

Gjithashtu, vlerësohet se, objekt i kërkesës së ankuesit nuk janë akte apo dokumente të përpiluara apo që mbahen nga Autoriteti Publik (Neni 1 i ligjit 119/2014) në kuadër të veprimtarisë së tij institucionale, por dokumentacion arkivor, publikimi i të cilit rregullohet sipas një procedure të veçantë të parashikuar në ligjin specifik.

Nga ana tjetër, duke pasur parasysh interesin që paraqesin publikimet studimore të fakteve dhe rrethanave që janë objekt i veprimtarisë së institucionit, Zyra e Komisionerit rekomandon vlerësimin nga ana e Autoritetit Publik të bërjes publike, pas përpunimit, qoftë si rubrikë e programit të transparencës, qoftë në çdo formë tjetër me ose pa kërkesë, të informacionit që është bërë një herë publik më parë. Kjo do t'i shërbente efikasitetit të punës së Autoritetit Publik si dhe publikimeve studimore dhe historike lidhur me faktet që karakterizojnë periudhën e cila është objekt i veprimtarisë së Autoritetit Publik.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën Qendrës "Birn Albania" ndaj Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, Komisioneri vlerëson se ankesa është e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative' i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 793 Prot., datë 20.05.2019 të Qendrës "Birn Albania", përfaqësuar nga z. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik "Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit", me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
3. Ky vendim u shpall sot në datë 10 . 6 .2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

